

Procedura e Licencimit dhe Përmbajtja e Licencave për Energji Elektrike

Merita Kostari,
Kryesuese e Departamentit Ligjor dhe të Licencave
Anëtare e Bordit të ZRRE-së

Prishtinë, Shtator 2006

Procedura e Licencimit dhe prezantimi i përbërjes së Licencave

- i** Miratimi dhe shpallja e Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nga Bordi i ZRRE-së - **me 24 Shkurt 2006.**
- i** Rregulli ka hyrë në fuqi 1 muaj pas miratimit (neni 48.1 i Rregullit) - **me 24 Mars.**
- i** Neni 49.1 i Rregullit parasheh aplikimin e ndërmarrjeve të energjisë për licenca brenda afatit **nëntëdhjetë (90) ditësh** pas hyrjes në fuqi.
- i** Neni 33.2.i Ligjit të Rregullatorit për Energji parasheh se ZRRE-ja: **mund të lëshojë licencën, lëshojë licencën me kushte**, apo të **refuzojë lëshimin e licencës** me arsyetim.



Procedura e Aplikimit për Licenca

- ❶ Afati për aplikim për licencë tek ZRRE-ja **ka qenë 24 Qershor** e afati për lëshimin e licencave- **24 Shtator**.
- ❷ Pas shpalljes së Rregullit për Licencim ZRRE-ja e ka publikuar atë, si dhe formën e aplikacionit për licenca.
- ❸ Me datën 4 Maj kemi mbajtur një **tryezë pune** me KEK-un (të gjitha divizionet). Tryeza është mbajtur me qëllim që t'u lehtësohet aplikuesve procedura e aplikimit.
- ❹ Nga KEK-u është marrë **lista e të gjithë tregtarëve** që kanë importuar energjinë elektrike (ose KEK-u ka blerë nga ata) dhe të gjithë janë ftuar nga ZRRE-ja që të aplikojnë.



Procedura e Aplikimit për Licenca

- ❶ Prej 18 tregtarëve sa janë ftuar kanë aplikuar ndërmarrjet: EGL, EFT dhe EZPADA kurse pas shqyrtimit të aplikacioneve kanë aplikuar **edhe 3 tregtarë tjerë.**
- ❷ Aplikacionet që kanë arritur pas afatit 90 ditësh nga data e cekur në fillim të këtij prezantimi do të vlerësohen dhe do të diskutohen **në sencën e veçant publike.**
- ❸ Duke filluar nga 24 Gusht ZRRE-ja ka kërkuar nga Aplikuesit (varësisht nga kompletimi i lëndës së tyre) **që të botojnë** në 2 gazeta ditore një përmbledhje rreth aplikacionit që e kanë ushtruar dhe informatën që ZRRE-ja është në proces të shqyrtimit të aplikacioneve. Të gjithë e kanë bërë publikimin.
- ❹ Me 24 Gusht ZRRE-ja ka filluar me dërgimin e faturave ndërmarrjeve për pagesën e taksave fillestare për shqyrtimin e aplikacioneve që paguhen sipas Pasqyrës së Taksave (Rregulli i miratuar nga Bordi i ZRRE-së).

Procedura e Aplikimit për Licenca

❶ KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A-(“KEK ”):

- Me **23 Qershor 2006** ka aplikuar për Licencë Gjenerimi, Licencë Shpërndarje, Licencë për Furnizim Publik dhe Licencë për Furnizimi/ tregti me energji elektrike.
- Në periudhen prej **10 Korrik deri me 03 Shtator** janë kërkuar disa herë nga ndërmarrjet plotësime me dokumente që nevojiteshin ose informata shtesë dhe ato janë plotësuar deri me 04 Shtator, ndërsa **me 18 Shtator** është dërguar edhe **Leja e Përkohshme e Mjedisit** .
- **KEK-ut** i janë dërguar **draft licencat** relevante (4) dhe **KEK-u i ka dërguar komentet** kështu që ato janë marrë parasysh në verzionin e fundit të licencave.

Procedura e Aplikimit për Licenca

KOSTT-OPERATOR I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT:

- Ka aplikur **me 26 Qershor 2006** për licencë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Licencë për Operator Tregu.
- Me datë **26 Korrik** dhe disa here me vonë janë kërkuar dokumenta që mungonin kurse deri me **25 Gusht 2006** aplikacioni është kompletuar.
- KOSTT-it ka pranuar **draft licencat (2X)** nga ZRRE-ja për komente dhe i ka dërguar komentet, të cilat janë marrë parasysh nga ZRRE.

TRIANGLE GENERAL CONTRACTORS-dega në Kosovë

- Ka aplikur me 26 Qershor 2006 për Licencë Gjenerimi të Energjisë Elektrike.
- Deri me 21 Gusht janë dorëzuar në ZRRE dokumentet shtesë që janë kërkuar, përpos Lejes së Mjedisit.

Procedura e Aplikimit për Licenca

- Aplikuesi ka dërguar në ZRRE **Lejen nga MMPH për rehabilitim e HC, Lejen e Ujit** si dhe **Deklaraten e nënshruar dhe vulosur** se ka aplikuar në MMPH për Leje Mjedisore, dhe në momentin kur lëshohet leja nga MMPH, ajo do të dërgohet në ZRRE. (Leja e Përkohshme e dorqzuar me 18 Shtator).
- TRIANGLE ka pranuar draft licencën nga ZRRE për komente dhe ka dërguar komente të cilat janë marrë parasysh.

“IBER LEPENC” për HC Ujmani

- Me **27 Qershor 2006** ka dorëzuar Aplikacionin për Licencë Gjenerimi të Energjisë Elektrike.
- Nga **04 Gushti** dhe disa herë më vonë ZRRE-ja ka kërkuar dokumenta që mungonin ose informata shtesë.

Procedura e Aplikimit për Licenca

- Përfundimisht me datë **11 Gusht 2006** janë sjellë të gjitha dëshmitë e lartcekura, përveç Lejes së Mjedisit dhe Lejes së Ujit, në vend të së cilëve aplikuesi e ka derguar **Deklaratën të nënshruar dhe vulosur** se ka aplikuar në MMPH dhe se do t'i dorëzohet ZRRE-së në momentin e marrjes së kësaj leje nga MMPH. Me 18 Shtator e ka derguar edhe Lejen e përkohshme të Mjedisit.

- Ka pranuar draft licencën për gjenerim nga ZRRE dhe nuk ka pas komente.

Format e licencës tonë përmbajnë kushte të dosmodoshme për të licencuarin: p.sh – që të veproi në përputhje me të gjitha legjislacionet e aplikueshme për ambient në Kosovë ose: që të veproi në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm mbi marrëdhnie pune dhe sigurinë në punë;

Procedura e Aplikimit dhe Licencimit

rreth raportimit të rregullt, që ç'do i licencuar duhet të paraqet tek ZRRE-ja ndyshimet që kanë pasuar në ndonjë fakt që është parashtruar gjatë aplikimit, standardet e furnizimit, transmisionit, shpërndarjes etj.

Licenca është **përmbledhje e dispozitave relevante** që bazohen në:

- Ligjin e Energjisë,
- Ligjin e Energjise Elektrike,
- Ligjin e Rregullatorit të Energjisë Elektrike,
- Rregullin e Licencimit të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Rregullin e Zgjidhjes së Kontesteve,
- Pasqyrën e Taksave;
- Draft Rregullat e Tregut
- Rregullat tjera që janë miratuar nga Bordi i ZRRE- së në seancat paraprake publike.

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

1) Draft Licenca për Gjenerim të Energjisë Elektrike – për “Ibër Lepenc” dhe “TRIANGLE” për HC

Pjesa I – Termat e Licencës bazohen në Nenin 6 të Ligjit të Energjisë Elektrike.

Kohëzgjatja e licencës **është 20 vite** (për Triangle bazuar në Marrëveshje për Blerje të Energjisë me KEK-un) kurse për Ibër Lepenc, në bazë të vlerësimit (**sipas Ligjit – maximum 30 vjet**)

Neni 1: Përkufizimet dhe interpretimet (definicionet nga Ligji i Energjisë, Ligji i Energjisë Elektrike dhe Ligji i Rregullatorit të Energjisë);

Neni 2: Llogaritë e ndara për Bizneset Gjeneruese - sipas Nenit 26.1 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;



Baza ligjore në dispozitat e Licencës

Neni 3: Ndalimi i ndër-subvencioneve - sipas Nenit 46 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;

Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit - sipas Neni 15.4 të Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë ;

Neni 5:Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës - sipas Nenit 15.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Nenit 1.4 e) të Rregullit për Licencim;

Neni 6: Shpërndarja qendrore – ne bazë të draft Rregullave të Tregut;

Neni 7: Shërbimet ndihmëse - sipas Nenit 22 dhe 24.1 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;

Neni 8: Caktimi i Operatorit – që emërohet individi i përshtatshëm dhe i kualifikuar për operimin e njësive gjeneruese;

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

Neni 9: Rregullat e Tregut – në bazë të draft Rregullave të Tregut

Neni 10: Shëndeti dhe Siguria - sipas Neneve 21 dhe 23.2 të Rregullit për Licencim;

Neni 11: Mjedisi - Sipas Nenit 11.4 dhe 21 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Ligjeve dhe akteve nënligjore nga MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor);

Neni 12: Puna - sipas Nenit 11.4 të Rregullit për Licencim;

Neni 13: Tjetërsimi dhe heqja e Aseteve të të Licencuarit - sipas Nenit 42 të Rregullit për Licencim;

Neni 14: Obligimi i Sigurimit - sipas Nenit 29.2 të Rregullit për Licencim;

Neni 15: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit - sipas Nenit 36 dhe 29.1 të Rregullit për Licencim;

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

Neni 16: Shërbimet Publike të Detyrueshme - sipas Nenit 8 të Ligjit për Energji Elektrike

Neni 17: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së -sipas Neneve 13.1 dhe 27.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

Neni 18: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës – Kapitulli 9 i Rregullit të Licencimit;

Neni 19: Taksat – sipas Pasqyrës së Taksave;

Neni 20: Masat dhe Gjobat Administrative – sipas Nenit 57 të Ligjit të Rregullatorit të Energjisë dhe draft Rregullit mbi Masat dhe Gjobat Administrative;

Neni 21: Zgjidhja e Kontesteve – sipas Nenit 2.1 të Rregullit për Zgjidhjen e Kontesteve.

2) Draft Licenca për Gjenerim të Energjisë Elektrike me Kushte për KEK Sh.A (Kosova_A)

-Të gjitha Nenet si në Draft Licencën Nr. 1 (Gjenerimi nga HC)përpos në Pjesën e I-rë -Termet e Licencës – kohëzgjatja e Licencës është 5 vjet (gjatë kohëzgjatjes teknike të njesive të centralit ekzistues);

- Poashtu në Nenin 2 (**Llogaritë e ndara për Bizniset Gjeneruese**) është parashtuar Kushti:

“Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencim,i Licencuari duhet të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence”.

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

Në Nenin 5 - Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës është parashtruar kushti tjetër ku për implementimin e Nenit parashihet sipas orarit kohor që do të përcaktohet varësisht prej asaj kur Kodet e cekura më lartë përgatiten dhe miratohen”.

Në Nenin 10: Rregullat e Tregut është vendos kushti ku ZRRE-ja mund të nxjerrë urdhëresa me të cilat liron të licencuarin nga obligimet e parapara në paragrafin 1,2 dhe 3 më poshtë sa i përket pjesëve të Rregullave të Tregut në atë masë që do të precizohet në ato urdhëresa.

Në Nenin 12: Mjedisi – është dhënë Kushti i një afati kohor për sigurimin e Lejes për Mbrojtjen e Mjedisit nga MMPH, në rast se lëshohet leja me ndonjë afat kohor nga MMPH. Varësisht nga leja do të analizohet kohëzgjatja e implementimit me KEK-un.

3) Draft Licenca për Gjenerim të Energjisë Elektrike me Kushte për KEK Sh.A (Kosova_B)

-Të gjitha Nenet si në Licencën për Gjenerim për Kosovën A përpos në **Pjesën e I-rë** – kohëzgjatja e Licencës është 20 vjet. Varësisht nga leja që merret nga MMPH Neni 12: Mjedisi dhe afatet duhet të analizohet përseri me KEK-un.

4)Draft Licenca për “Furnizim Publik me Energji Elektrike” – (vetëm për KEK-un)

- **Pjesa I – Termat e Licencës** bazohen në **Nenin 6 dhe 9** të Ligjit mbi Energjinë Elektrike ku KEK-ut i lejohet shitja ekskluzive konsumatorëve të rregulluar (tarifuar) dhe kohëzgjatja e kësaj licence është 10 vjet (sipas Neni 31 i Ligjit të Rregullatorit të Energjisë);

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- **Neni 5 :Pajtueshmëria me Kodet por edhe me Rregullin mbi Kushtet Përgjithshme të Furnizimit me Enejë Elektrike** - sipas Nenit 15.2 të LRRE,Nenit 1.4 e) të Rregullit për Licencim dhe Nenit 4.2 b) të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Enejë Elektrike;
- **Neni 6: Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit** - sipas Nenit 3 të Rregullit për Licencim;
- **Neni 7: Mbrojtja dhe Siguria** - sipas Nenit 11.4 të Rregullit për Licencim;
- **Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes** - sipas Nenit 19 të Rregullit për Licencim.

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

1

Neni 9: Procedurat për zbulim dhe parandalimin e vjedhjeve, dëmtimeve dhe ndërhyrjeve në njehsor – Neni 28.7 i Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Nenet tjera si në licencën paraprake.

5) Draft Licenca për “Furnizim/Tregti me Energji Elektrike” (për KEK Sh.A, dhe tregtarët tjerë (EGL, EFT dhe EZPADA)

1

Të gjitha Nenet janë të njëjta si Licencat për Furnizim Publik përveç Pjesës Nr. I - Termat e licencës, ku baza ligjore është Neni 23.3 i Ligjit për Energji Elektrike dhe kohëzgjatja e këtyre licencave është 2 vjet (Neni 31 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë). Në këtë Licencë mungojnë **Neni 19 – Shërbimet Publike të Detyrueshme dhe Neni 6 – Qeversja e Detyrimeve të të Licencuarit.**



ERO

6) Draft Licenca për Shpërndarje për KEK Sh.A-me Kushte

- **Neni 5: Funkionimi i Sistemit të Shpërndarjes** - sipas **Nenit 11** të Ligjit të Energjisë, Metodologjisë së Tarifave, Rregullës mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave, Nenet 17, 18, 19, 25, 26, 30 dhe 31 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.
- **Neni 6: Plani Zhvillimor** Sipas **Nenit 18** të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- **Neni 7: Blerja ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndihmëse** -sipas Neni 42 te Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- **Neni 9: Furnizimi me mjetet matëse dhe shërbimet e të dhënave** (sipas Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me Energji Elektrike);

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

-Neni 10:Zbulimi dhe parandalimi i vjedhjes së energjisë elektrike, dëmtimi dhe ndërhyrja në njehsor - sipas Nenit 22.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

-Neni 11: Standardet e sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit – sipas Nenit 4 dhe Nenit 38.7 të Ligjit për Energji Elektrike (në afat prej 12 muaj).

-Neni 12: Standardet e Sigurisë së Operimit – sipas Nenit 4 dhe Nenit 38.7 të Ligjit për Energji Elektrike (në afat prej 12 muaj).

Neni 13:Standardet e përgjithshme dhe minimale të përmbushjes së bizneseve të shpërndarjes – 6 muaj, sipas Nenit 33 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- **Neni 14: Qasja në tokë dhe/ose në ndërtesa (godina)** Neni 26 i Ligjit mbi Energjinë;
- **Neni 15: Kufizimi në përdorimin e informatës së caktuar**
 - sipas Rregullit për Informatat Konfidenciale dhe Neni 13 dhe 50.2 i Ligjit të Rregullatorit për Energji Elektrike.
- **Neni 16: Furnizimi me informata për OST** - draft Rregullat e Tregut;
- **Neni 17: Informatat tjera për konsumatorët** - sipas Neni 31 të Rregullit për Licencim;
- Neni 18: Kodi i Sjelljes i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.**
- Neni: 22: Obligimi i Sigurimit**-ku përsëri është dhënë kushti 12 muaj për lidhjen e kontratës së sigurimit për asetet e shpërndarjes.



Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- **Neni 24: Shërbimet Publike të Detyrueshme** - sipas Nenit 22.4 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Licenca ipet në kohëzgjatje prej - 30 vjet.
- Nenet tjera si në licencat paraprake.

7) Draft Licenca për KOSTT-për Transmision (me kushte)

- Te gjitha Nenet janë të njëjta si në **Licencen për Shpërndarje** të Energjisë elektrike, përveç se kjo licencë ka disa nene tjera specifike:

Neni 8- Balanci i Energjisë - sipas Nenit 6 të Ligjit për Energji,

Neni 10: Ndërlidhësit dhe

Neni 11: Operimi i Sistemit - sipas Neni 38.7 i Ligjit për Energji Elektrike dhe draft Rregullave të Tregut.

Baza ligjore në dispozitat e Licencës

- Natyrisht kjo Licencë nuk ka Nenet si licenca e Shpërndarjes sa i përket: Zbulimit dhe Parandalimit të Vjedhjes së Energjisë elektrike, Dëmtimi dhe Ndërhyrja në Njehsor dhe Informatat tjera për Konsumatorët.
- Licenca ipet në kohëzgjatje prej- 30 vjet.

7) Draft Licenca për KOSTT-për Operator Tregu (me Kushte)

- Të gjitha Nenet janë të njëjta si në Licencën për Transmision të Energjisë Elektrike, përveç se kjo licencë ka disa Nene tjera Specifike që bazohen në Rregullat e Tregut:



Baza ligjore në dispozitat e Licencës

Neni 8 : Qasja në Rregullat e Tregut;

Neni 9: Komunikimet Operacionale;

Neni 10 Disponueshmeria e Kapacitetit;

Neni 12: Njoftimi mbi Kontratën e Energjisë;

Neni 13: Parashikimi i Operatorit të Sistemit;

Neni 14: Llogaritë perfurndimtare dhe Çmimet e Mosbalancit të Energjisë.

Licenca ipet në kohëzgjatje prej- **30 vjet**.



ERO

Zyra e Rregullatorit për Energji



Faleminderit!!!

Zyra e Rregullatorit për Energji

Rr."Hamdi Mramori"Nr. 1

10 000-Prishtin, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 101

Fax: +381 (0) 38 247 620

e-mail: info@ero-ks.org

www.ero-ks.org 25



ERO

www.ero-ks.org